

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E ENJTE 21 PRILL 2022

Të nderuar deputetë,

Kam ndjekur prej disa orësh dhe së fundi diskutimet në Kuvend, ku u fol për shpresën, mungesën e shpresës, ikjen; u fol për rritjen e çmimeve, me synimin e pamundur për të bindur veten, deputetët e tjerë dhe të gjithë qytetarët se rritja e çmimeve nuk ka lidhje me situatën globale, me luftën; u fol për amnistinë fiskale, për mungesën e bazës morale të amnistisë, a thua se po e shpikim ne amnistinë fiskale si instrument dhe mendova të marr fjalën e të them disa mendime të miat!

Së pari, çështja e shpresës nuk është çështje vetëm e një momenti, e një viti apo e një ekuacioni numrash, por është çështje psikologjike dhe te psikologjia kontribuon si qeveria, ashtu dhe opozita. Kështu që mirë është të merrni edhe ju rol te mungesa apo lindja e shpresës, sepse nga ky parlament gjenerohen mesazhe, të cilat lexohen nga opinioni si mesazhe optimiste, pesimiste, që i shtyjnë drejt investimit për të ardhmen në vendin e tyre, në qytetin e tyre, në fshatin e tyre apo të ikin nga sytë këmbët kur shikojnë që këtu të zgjedhurit e qytetarëve nuk merren vesh për çështje shumë të thjeshta, në fakt, dhe të trishta, siç është situata me rritjen e çmimeve, pasiguria ushqimore, mungesat në tregjet globale, pasojat që ka lufta në të gjithë botën, ashtu dhe në vendin tonë. Dje ka pasur një sqarim gjerë e gjatë nga presidenti i Bankës Botërore në lidhje me se si po ndikon situata në Ukrainë, agresioni rus në rritjen e çmimeve dhe si do të vazhdojë kjo mbase për shumë kohë.

Nuk e dimë kur mbaron lufta, por, kurdo që të mbarojë, edhe nëse mbaron sot, stabiliteti i tregjeve do të dojë kohë. Atëherë, ne si Shqipëri dhe si shqiptarë si do të futemi në këtë kohë që po vjen? Do të futemi kështu, të ndarë, si macja me miun, duke u grindur për çështje që nuk janë të nevojshme të kuptohet se nga vijnë, por të adresohen më mirë? Këtu patjetër që ka nevojë për pozitë dhe opozitë, patjetër që ka nevojë për alternativa, ne nuk jemi perfektë, mbase po të ishit ju do ta kishit bërë më të mirë paketën e rezistencës sociale, por kur shigjetoni gjithçka duhet të shihni edhe nga vetja, sepse ka dy mënyra se si mund të flisni këtu: ose duke sjellë shembullin e qeverisjes suaj, ose duke thënë që keni qeverisur keq, por keni ndryshuar dhe jeni rinovuar. Se si jeni rinovuar këtë po e shohin qytetarët shqiptarë çdo ditë, dhe unë e kuptoj që jeni në pozitë të vështirë. Por, nuk do të bënit keq dhe nuk do të humbnit elektorat nëse do të kalonit nga qasja negative, kundër gjithçka, në një qasje më konstruktive, gjë që nuk do të thotë të bashkoheni me ne në duartrokitjet e qeverisë, por do të thotë të sillni këtu propozime, të cilat t'i besoni, së pari, ju vetë, pastaj t'ia shisni opinionit.

Paketa e rezistencës sociale ka prekur të gjitha shtresat që janë më të ekspozuara nga rritja e çmimeve, pra janë shtresat më vulnerabël dhe më në nevojë. Natyrisht, nuk jemi mjaftuar vetëm me përkujdesjen sociale, por kemi çliruar dhe mobilizuar edhe instrumente të tjera që grumbullojnë burime, siç është amnistia. Zonja Tabaku, nuk është se nuk jam dakord me ju, që ka një problem moral tek amnistia në raport me ata që për shumë vite i kanë thënë jo evazionit apo informaliteti, dhe kjo është e vërtetë. E kemi pranuar që e kemi stërzgatur tranzicionin në Shqipëri, këto janë fenomene tranzicioni dhe

tranzicioni mbaron me amnisti, sepse amnisti keni bërë edhe ju. A kishte bazë morale amnistia juaj? A kishte bazë morale legalizimi, që e filluat ju, e vazhduam ne dhe po e përmbyllim me shumë shpejtësi dhe me shumë të drejtë?

Natyrisht, ka një problem moral në raport me ata qytetarë, të cilët nuk kanë nevojë për legalizim, se e kanë respektuar ligjin gjatë 30 vjetëve të atij që e quajmë tranzicion, por, kur masivizohet kaq shumë një fenomen, si ndërtimet pa leje, informaliteti, evazioni, ka nevojë për një zgjidhje dhe jo vetëm për shigjeta. Zgjidhjet janë këto: nga njëra anë adresojmë në mënyrë të shpejtë, emergjente me akte normative (të cilat janë kushtetuese, ligjore), me ndërhyrje në ligj, me mobilizim të paketave të rezistencës sociale dhe të përkujdesjes; nga ana tjetër përdorim instrumente inovative për të grumbulluar më shumë burime në një kohë më të shpejtë. Ajo që është shumë e rëndësishme të diskutohet dhe të debatohet, që e diskutojmë kaq pak, është: çfarë do të bëjmë në të ardhmen, në 5 apo 10 vjet, pavarësisht se kush është në qeveri. Situata që po troket nuk është e lehtë për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Europës dhe globit, nëse doni.

Të gjithë duhet të shohim nga mundësitë e ristrukturimit të ekonomisë, të gjejmë degë të reja ekonomike. Pak më vonë do të diskutojmë për një projektligj, që mund të kalojë si pa u vënë re, se do të jetë i fundit, por që është shumë i rëndësishëm. Nuk bëhet fjalë për efekte financiare shumë të mëdha, por bëhet fjalë për krijimin e instrumenteve, në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe atyre mikro, instrumente financiare që nuk kanë ekzistuar më parë, që mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë biznesin e vogël, që është punëdhënësi më i madh i marrë në total në Shqipëri, dhe inovacionin apo kërkim-zhvillimin. Për shembull, mund ta pranojmë që Shqipërisë në kërkim-zhvillim kemi mungesë efience për shkak të trashëgimisë jo vetëm gjatë këtyre 30 vjetëve, por edhe shekuj më parë. Ne bëjmë pak me shumë, ndërkohë që duam të kalojmë në një kulturë të re, të bëjmë më shumë me më pak, pra të jemi më eficientë dhe të investojmë në kërkim-zhvillim.

Për këtë arsye kemi përgatitur këtë projektligj, që t'i japim biznesit subvencione, grante, mbështetje financiare nga buxheti për të zhvilluar zgjidhje të reja, për t'u bërë inovativë dhe për t'u rritur, duke rritur produktivitetin. Produktiviteti është çelësi dhe zgjidhja për të cilën kjo qeveri po punon sot. Kjo është e reja dhe ndryshimi i madh i të gjithë kulturës qeverisëse të kësaj qeverie me atë të 30 vjetëve të kaluara. Nuk është investuar asnjëherë në produktivitet dhe për këtë arsye sot Shqipëria nuk është nga vendet më të dalluara në inovacion dhe sa produkt nxjerr me burimet e veta. Zoti na ka dhënë shumë burime dhe kemi nxjerrë pak rezultat në vite. Ndërkohë, ka vende me shumë pak burime dhe kanë nxjerrë shumë. Ky është produktiviteti. Për shembull, nëse krahasojmë Holandën me Rusinë, Holanda është 450 herë më e vogël se Rusia si sipërfaqe dhe eksporton 8 deri në 9 herë më shumë produkte bujqësore.

Pra, projektligji që vjen më pas, se nuk dua ta marr fjalën përsëri, synon si një hap të vogël në fillim, por që jam i bindur se do të rritet më vonë, ta fusë ekonominë dhe biznesin (sipërmarrjen) në një kapitull të ri, të atij që quhet venture capitalist, pra të mobilizojë fonde nga jashtë për bizneset që premtojnë rritje bazuar tek inovacioni, kreativiteti dhe te zgjidhjet e reja. Le të futemi në këtë hapësirë diskutimi dhe debati, ku jam i bindur që edhe ju do të gjeni vend për të krijuar kapital politik jo me negativitet, jo me

shigjeta kuturu, por me alternativa, për të cilat patjetër që i keni kapacitetet. Nëse e vrisni mendjen, mund të sillni në vlerë të shtuar për parlamentin dhe pse jo për qeverisjen. Faleminderit!